# ACRISYL DECORA

VESHJE (RIVESTIMENTO) AKRIL-SILOSANIKO PËR JASHTË ANTIMYK ANTIALGA DEKORATIVE ME EFEKT GRANITI ME KRISTALE ME SHKËLQIM

SERI 457

## PËRSHKRIMI

ACRISYL DECORA është një veshje murale për jashtë, e pasur me kristale me shkëlqim që realizojnë një finiturë me aspekt tipik graniti dhe gurësh natyralë të karakterizuar nga grimca të vogla kristali sipërfaqësore.
Me bazë lidhës akril-silosaniko, krijon një veshje mbrojtëse me rezistencë të lartë ndaj ujit dhe përshkueshmëri të mirë të avujve. Realizon sipërfaqe me fuqi të lartë papërshkueshmërie nga ndotësit atmosferikë dhe të mbrojtura nga zhvillimi I mykut dhe algave.
Për karakteristikat e saj ACRISYL DECORA është e përshtatshme edhe për finitura dekorative në veshje termike cappotto.

## UDHËZIME PËR PËRDORIM

E aplikueshme në:
-Sipërfaqe të trajtuara me veshje termike ”cappotto”.
-Suva të reja dhe të vjetra me bazë lidhësa hidraulikë.
-Sipërfaqe betoni.
-Bojra të vjetra dhe veshje me natyrë organike ose minerale, të thata, kompakte, absorbuese dhe kohezive.
-Konglomerate me natyrë të ndryshme minerale me kusht që të jenë absorbuese.
Sipërfaqet përgatiten përshtatshmërisht duke ndjekur udhëzimet në paragrafin “Përgatitja e Sipërfaqes”.
Mos aplikoni në sipërfaqe të pathara mirë/freskëta dhe me tendencë alkaline, prisni një kohë të përshtatshme maturimi (tharje), përgjithësisht prej 4 javësh.

## KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

-Natyra e lidhësit: kopolimer akrilik me modifikime silosanike në emulsion ujor
-Solventi: ujë
-Viskoziteti: qëndrueshmëri pastoze
-Granulometria: 0,6 mm
-Rezistenca ndaj alkaleve UNI 10795: rezistente
-Shënjimi CE sipas EN 15824
-Reaksioni ndaj zjarrit EN13501: Klasi B s1 d0
-Përshkueshmëria në ujë likuid UNI EN 1062-3: e ulët, w<0,1 kg/m2h^0,5
-Përshkueshmëria në avuj ujorë UNI EN ISO 7783-2: e lartë, Sd<0,14 m
-Mbrojtës për fasada në bazë të teorisë së Kuenzle DIN 18550: W<0,5 kg/m2h^0,5 dhe Sd<2 metra
-Rezistente ndaj mykut dhe algave sipas UNI EN 15457 dhe UNI EN 15458
-Tharja (në 25 °C dhe 65% U.R.): komplet për 1 orë e 30' deri në 3 orë sipas spesorit të aplikuar.

## PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Sipërfaqe në suva:
-Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e tharë mirë dhe e maturuar. Nëse është e nevojshme siguroni konsolidim me produkte specifike.
-Në prani të mykut trajtojeni sipërfaqen me detergjentin COMBAT 222 kod. 4810222 dhe me detergjentin COMBAT 333 kod. 4810333 (I cili penetron në brendësi/thellësi të sipërfaqes).
-Hiqni,me zmerilim ose me ujë me presion mesatar, mykun prezent dhe pluhurat e bojës së vjetër. Eliminoni shtresat e ngritura të bojës në gëlqere ose bojës transpirante/tempera.
-Hiqni smogun, pluhurat dhe çdo ndotje tjetër me zmerilim
-Çarjet duhet të zgjerohen sa duhet dhe të mbushen me llaç, stuko ose produkte të ngjashme.
-Niveloni parregullsitë e sipërfaqes. Plasaritjet dhe uljet mund të trajtohen me BETOMARC 9450150, me RASAMIX 9440160, me RASOMARC 9500150 në varësi të llojit të sipërfaqes.
-Sigurohuni që sipërfaqa të jetë e thatë dhe aplikoni një shtresë astari me solvent ISOMARC 4410111 ose me astar të mikronizuar solvent-free ATOMO 8840001. Për sipërfaqe të qëndrueshme pa pluhur, aplikoni astarin mbulues të hollueshëm me ujë MARCOTHERM PRIMER 4740019.
-Në sipërfaqe jo uniforme mund të aplikohet një shtresë astar riempitiv uniformues akril-silosanik ACRISYL GRIP kod. 9320019.
-Vazhdoni me aplikimin e ACRISYL DECORA sipas udhëzimeve të përshkruara në instruksionet për aplikim.

**Sipërfaqe betoni:**
-Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e tharë mirë dhe e maturuar. Nëse është e nevojshme siguroni konsolidim me produkte specifike.
-Në praninë e mykut trajtojeni sipërfaqen me detergjent COMBAT 222 kod 4810222 dhe me detergjentin COMBAT 333 kod. 4810333 (I cili

Eraldiplak

penetron në brendësi/thellësi të sipërfaqes).
-Hiqni,me zmerilim ose me ujë me presion mesatar, mykun present dhe pluhurat e bojës së vjetër. Eliminoni shtresat e ngritura të bojës në gëlqere ose bojës transpirante/tempera.
-Hiqni smogun, pluhurat dhe çdo ndotje tjetër me zmerilim
-Hiqni pjesët e dëmtuara të çimentos
-Shufrat metalike të armaturës në sipërfaqe duhet të zmerilohen dhe të trajtohen me BETOXAN PRIMER 9490125 Boiacca passivante.
-Rivendosni pjesët që mungojnë me zbutësin BETOXAN 400 ose BETOXAN 300 llaç tiksotropik anti-tkurrje me fibra të përforcuara 9490140/130; kryeni stukimin përfundimtar me anti-karbonatizuesin anti-tkurrje BETOXAN 200 9490120.
-Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e tharë dhe aplikoni një shtresë astari me solvent ISOMARC 4410111 ose me astar te mikronizuar solvent-free ATOMO 8840001. Për sipërfaqe të qëndrueshme pa pluhur, aplikoni astarin mbulues të hollueshëm me ujë MARCOTHERM PRIMER 4740019.
-Në sipërfaqe jo uniforme mund të aplikohet një shtresë astar riempitiv uniformues akril-silosanik ACRISYL GRIP kod. 9320019.
-Vazhdoni me aplikimin e ACRISYL DECORA sipas udhëzimeve të përshkruara në instruksionet për aplikim.

**Sipërfaqe me veshje termike "cappotto":**
-Sigurohuni që sipërfaqja të ketë një kohë maturimi konform me specifikat e prodhuesit.
-Kontrolloni gjendjen e stukimeve, sipërfaqja duhet të jetë e qëndrueshme.
-Aplikoni një shtresë astar të mikronizuar solvent-free ATOMO 8840001 ose astar mbulues të hollueshëm me ujë MARCOTHERM PRIMER 4740019.
-Vazhdoni me aplikimin e ACRISYL DECORA sipas metodave të përshkruara në udhëzimet për aplikim.

*(Hollimi I astarit dhe sasia për tu aplikuar janë në funksion të absorbimit të sipërfaqes dhe përcaktohen me prova paraprake në sipërfaqje specifike. Konsultohuni me skedën teknike përkatëse).

## UDHËZIME PËR APLIKIM

Temperatura e ambientit: Min. +8 °C / Max. +35 °C
Lagështira relative e ambientit: <75%
Temperatura e sipërfaqes: Min. +5 °C / Max. +35 °C
Lagështira e sipërfaqes: <10%
-Shmangni aplikimin në prani të kondensimit sipërfaqësor ose nën ndikimin direkt të diellit.
-Për të mos dëmtuar karakteristikat estetike dhe performancën optimale të produktit, rekomandohet aplikimi në kushte klimatike të duhura dhe mbrojtja nga shiu dhe lagështira për rreth 48 orë. Në këtë mënyrë lejohet tharje e plotë e produktit dhe polimerizim I rregullt,që ndodh në rreth 10 ditë.
-Sipërfaqet që preken nga shiu gjatë rreth 10 ditëve, mund të shfaqin vija vertikale të tejdukshme. Kjo nuk ndikon në performancën e produktit dhe mund të hiqet duke e larë me ujë ose me produkte specifike.
-Aplikimi në sipërfaqe me myk, me tretësirë kripërash alkaline ose subjekt i lagështirës në rritje, nuk garanton ngjitjen e produktit në sipërfaqje, prandaj është e nevojshme ndërhyrja parandaluese e restaurimit të mureve me llaçin kundra-lagështirës NEPTUNUS dhe më pas bojatiseni me sistemin Silosanik NEPTUNUS.
-Mbrojtja e finiturave antimyk dhe antialga është me natyrë flijuese/sakrifikuese: efikasiteti dhe zgjatja në kohë janë shumë të kushtëzuara nga shkalla e ekspozimit klimatik dhe ambiental, nga tipologjia konstruktive dhe nga zgjedhja e sistemit aplikativ.
-Hollimi: gati për përdorim. Në kantier është I mundur rregullimi I viskozitetit, në varësi të nevojave, duke e holluar pak ACRISYL DECORA me 2-3% ujë.
-Përziejeni produktin para aplikimit.
-Mjetet: Mallë inoksi, mallë plastike.
-Nr shtresave: 2.
-Zgjedhja e mjeteve ndikon në rezultatin estetik të sipërfaqes, prandaj punoni gjithmonë me të njëjtat lloje mjetesh.
-Mënyrat e aplikimit:
Hapeni produktin në sipërfaqe në mënyrë homogjene me mallë inoksi. Prisni të thahet komplet, më pas aplikoni shtresën e dytë.
Aplikoni shtresën e dytë dhe, para se produkti të thahet totalisht, lishojeni shpatull inoksi për ta bërë sipërfaqen lisho.
Për të përftuar një efekt më të ngjashëm me suvanë civile aplikojeni produktin me mallë plastike dhe uniformojeni.

Erdi shk

-Për të shmangur formimin e nyjeve punoni në sipërfaqe të vazhdueshme, gjithmonë me produktin të njomë mbi të njomë.

-Rezultati estetik final mund të influencohet nga teknikat e aplikimit, këshillohet aplikim I saktë I shtresës finale.

-Mjetet duhet të pastrohen menjëherë pas përdorimit me ujë.

-Shkalla e mbulimit: 1-1,2 $kg/m^2$ për shtresë. Në punë të mbaruara në 2 shtresa 2-2,4 $kg/m^2$ në sipërfaqe mesatarisht poroze.

Është mirë që të përcaktohet shkalla e mbulimit me një provë paraprake në sipërfaqe specifike.

## NGJYROSJA

Produkti është I disponueshëm në bazat tintometrike, të përdorshëm edhe si ngjyra të gatshme, kristal (0001) dhe granito grigio (0002).

Ngjyrosja mund të arrihet përmes sistemit tintometrik Marcromie. Produkti gjithashtu mund të ngjyroset me kolorantët COLORADO seri 548.

Në rast të përdorimit të fabrikimeve të ndryshme është e këshillueshme të përzihen midis tyre produktet e ndryshme për të shmangur ndryshime në tonalitete. Në ndërhyrjet për jashtë ne rekomandojmë që të përfundoni punimin me materiale të të njëjtit prodhim. Për punë, në të cilat është i pashmangshëm përdorimi i një materiali të ri, mos e aplikoni afër materialit te përdorur më parë. Për rakordimin përdorni ndërprerjet e vazhdimësisë së sipërfaqes, kolonave, mbulesave, skajeve, kabllove ose të tjera.

## MAGAZINIMI

Temperatura maksimale e ruajtjes: +30 °C
Temperatura minimale e ruajtjes: +5 °C
Produkti preferohet të përdoret brenda 2 vitesh nga data e prodhimit, nëse është ruajtur në ambalazh origjinal të pahapur dhe në kushte në temperaturë të përshtatshme.

## UDHËZIME SIGURIMI

Vlera limite BE (Dir. 2004/42/EC)
Kat. C: bojë për mure të jashtëm të sipërfaqeve minerale (bazë uji): 75 g/l (2007) / 40 g/l (2010)
ACRISYL DECORA Përmban max: 40 g/l VOC

E dëmshme për organizmat ujorë, mund të shkaktojë, në periudhë afatgjatë, efekte negative në mjedisin ujor /Mbajeni larg përdorimit nga fëmijët / Mos i hidhni mbeturinat në kanalizime / Përdorni veshje mbrojtëse dhe doreza të përshtatshme / Në rast të gëlltitjes, konsultohuni menjëherë me mjekun dhe i tregoni enën ose etiketën.

Etiketimi I rrezikut sipas direktivave 67/548/CEE dhe 1999/45/CE dhe modifikimeve pasardhëse.

Produkti duhet të transportohet, përdoret dhe ruhet sipas rregullave aktuale të higjienës dhe sigurisë; I lini te thahen mbetjet tërësisht dhe i trajtoni ato si mbeturina të veçanta. Për më shumë informacion konsultohuni me skedën e sigurisë.

## SPECIFIKIMET

Rivestimento/ Veshje akril-silosanike antialga, të zbukuruar me kristale të vogla me shkëlqim. Aplikimi në 2 shtresa në sipërfaqe të predispozuara, edhe në sipërfaqe të trajtuara me veshje termike ”cappotto”, për ACRISYL DECORA seri 457, me bazë kopolimer akril-silosanik në dispersion ujor, me komponentë silicorë, granilje mermeri, kristale xhami.

Spesori mesatar I veshjes/rivestimentos në punë të mbaruar 1 mm.

Furnizimi dhe instalimi i materialit € ................ për m².

*SAN MARCO GROUP garanton që informacionet e kësaj skede janë marrë nga eksperienca e saj dhe nga njohjet e saj teknike dhe shkencore; megjithatë nuk mund të mbajë asnjë përgjegjësi për rezultatet e arritura duke qenë se kushtet e aplikimit janë jashtë kontrollit të saj. Këshillohet të verifikohet gjithmonë efikasiteti I produktit. Skeda e paraqitur anullon dhe zëvendëson çdo skedë të mëparshme. Për informacione të mëtejshme teknike kontaktoni në nr.pa pagesë të Asistencës Teknike 800853048.*